LIGJ
Nr. 12/2025

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 133/2015, "PËR TRAJTIMIN E PRONËS DHE PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË KOMPENSIMIT TË PRONAVE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave", i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në pikën 1, të nenit 11, fjalët "në 10 vjet" zëvendësohen me fjalët "deri në vitin 2028".

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 15, fjalët "brenda datës 31.12.2024" zëvendësohen me fjalët "brenda datës 31.12.2027".

Neni 3

Në pikën 6, të nenit 16, fjalët "brenda një afati prej 10 (dhjetë) vjetësh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji." zëvendësohen me fjalët "deri më 31.12.2028.".

Neni 4

Në pikën 1, të nenit 34, fjalët "brenda datës 31.12.2024" zëvendësohen me fjalët "brenda datës 31.12.2027".

Neni 5

Në tabelën që pasqyrohet në shtojcën 2, të ligjit nr. 133/2015, i ndryshuar, kolona "viti 10" zëvendësohet me kolonat e mëposhtme:

viti 10	**viti 11**	**viti 12**	**viti 13**
3	5,3	5,3	7,63

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.2.2025.

Shpallur me dekretin nr. 79, datë 28.2.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.